



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**

Datë: 30/12/2008

**Njoftim për Shtyp**

Mbi vendimin e Komisionit të Konkurrencës  
“Rekomandim për shfuqizimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1110,  
datë 30.07.2008 që kufizon konkurrencën në treg”

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 30/12/2008, shqyrtoi çështjen me objekt kufizimet të konkurrencës nga vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1110, datë 30.07.2008, “Për cilësinë e lëndës djegëse të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase”.

Sikurse është bërë me dije, Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar hetimin në tregun e karburanteve, i cili ka marrë në konsideratë sjelljen e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes me shumicë të karburanteve, si dhe efektin e akteve normative në funksionimin e këtij tregu.

Gjithashtu, pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një ankesë nga Shoqata e Shoqërive Hidrokarbure mbi Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1110, datë 30.07.2008. Ky shqetësim është ngritur edhe gjate seancave dëgjimore me ndërmarrje të tregëtimit të hidrokarbureve.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të “Raportit të Vlerësimit mbi Ndikimin e Akteve Ligjore dhe Nënligjore në Tregun e Karburanteve” e në mënyrë të veçantë për produktin lëndës djegëse diesel sipas standartit S SH EN 590 dhe ankesën e Shoqatës së Shoqërive Hidrokarbureve konstaton se: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1110, datë 30.07.2008, “Për Cilësinë e Lëndës Djegëse, të Prodhuar nga Rafinimi i Naftës Bruto, Vendase”, në tregun e produktit lëndë djegëse diesel, sjell kufizime të konkurrencës për shkak të aplikimit të kushteve të pabarabarta të tregëtimit ndërmjet ndërmarrjeve, në lidhje me produktin vendas dhe atë të importit

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 24, geramat “d” “f” dhe 70, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi t’i rekomandojë Këshillit të Ministrave shfuqizimin e VKM Nr. 1110, datë 30.07.2008, “Për cilësinë e lëndës djegëse të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase” pasi kufizon konkurrencën mes ndërmarrjeve që veprojnë në treg.